



**ПРОГРАМА ЗА КУЛТУРА**  
**на Општина Кичево за 2026 година**

**I. Вовед**

Предлог програмата за култура на Општина Кичево за 2026 година има за цел да го поттикне и унапреди културниот живот во општината, да ја афирмира културната разноликост, да ја поддржи креативноста и уметничкото творештво, како и да овозможи континуиран развој на културата како јавен интерес од локално значење. Програмата е насочена кон поддршка на институции, здруженија, физички лица, млади таленти и културни настани кои придонесуваат за зачувување и развој на културниот идентитет на Општина Кичево.

**II. Програмски активности и финансиски ставки**

**1. Изработка и доделување на благодарници и признанија**

Се предвидуваат средства за изработка и доделување на благодарници, плакети и други признанија за поединци, институции, здруженија и културни работници кои оствариле значаен придонес во развојот, афирмацијата и промоцијата на културата во Општина Кичево. Средствата се наменети за дизајн, печатење и изработка на соодветни признанија.

**2. Протоколарни и репрезентативни подароци**

Се предвидуваат средства за набавка на скромни и симболични протоколарни подароци за значајни гости, уметници и културни дејци кои учествуваат или присуствуваат на културни настани организирани или поддржани од Општина Кичево. Подароците ќе имаат културен, уметнички или промотивен карактер.

**3. Цвеќе и венци при одбележување на значајни настани**

Се предвидуваат средства за набавка на цвеќе и венци при одбележување на значајни историски датуми, културни празници, комеморативни настани и официјални посети на споменици и спомен-обележја од историско и културно значење.

Посебно се предвидува одбележување на:

- 7-ми март – Денот на наставниците Албанци, како значаен датум од образовно и културно значење;
- 22-ри ноември – Денот на албанската азбука, како празник од посебно значење за културниот и јазичниот идентитет.

**PROGRAMI PËR KULTURË**  
**i Komunës së Kërçovës për vitin 2026**

**I. Hyrje**

Propozim programi për kulturë i Komunës së Kërçovës për vitin 2026 ka për qëllim nxitjen dhe avancimin e jetës kulturore në komunë, afirmimin e diversitetit kulturor, mbështetjen e kreativitetit dhe krijimtarisë artistike, si dhe sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm të kulturës si interes publik me rëndësi lokale. Programi është i orientuar drejt mbështetjes së institucioneve, shoqatave, individëve, talenteve të rinj dhe ngjarjeve kulturore që kontribuojnë në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor të Komunës së Kërçovës.

**II. Aktivitetet programore dhe zërat financiarë**

**1. Përgatitja dhe ndarja e mirënjohjeve dhe çmimeve**

Parashikohen mjete për përgatitjen dhe ndarjen e mirënjohjeve, pllaketave dhe çmimeve të tjera për individë, institucione, shoqata dhe punonjës kulturorë që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin, afirmimin dhe promovimin e kulturës në Komunën e Kërçovës. Mjetet janë të dedikuara për dizajnimin, shtypjen dhe përgatitjen e mirënjohjeve përkatëse.

**2. Dhurata protokollare dhe reprezentative**

Parashikohen mjete për furnizimin me dhurata modeste dhe simbolike protokollare për mysafirë të rëndësishëm, artistë dhe veprimtarë kulturorë që marrin pjesë ose ndjekin ngjarje kulturore të organizuara ose të mbështetura nga Komuna e Kërçovës. Dhuratat do të kenë karakter kulturor, artistik ose promovues.

**3. Lule dhe kurora me rastin e shënimit të ngjarjeve të rëndësishme**

Parashikohen mjete për furnizimin me lule dhe kurora me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike, festave kulturore, ngjarjeve përkujtimore dhe vizitave zyrtare në monumente dhe memoriale me rëndësi historike dhe kulturore.

Veçanërisht parashihet shënimi i datave:

- 7 Mars – Dita e Mësuesve Shqiptarë, si datë me rëndësi arsimore dhe kulturore;
- 22 Nëntor – Dita e Alfabetit Shqiptar, si festë me rëndësi të veçantë për identitetin gjuhësor dhe kulturor.



#### **4.Поддршка и стимулирање на млади таленти од областа на уметноста**

Се обезбедуваат средства за поддршка на млади таленти од областа на музиката, ликовната уметност, театарот, литературата, филмот и други уметнички дисциплини. Поддршката може да се реализира преку: финансиска помош за учество на фестивали, натпревари и изложби; доделување награди и признанија; набавка на материјали и опрема; поддршка за едукативни и менторски програми.

#### **5.Поддршка на невладиниот сектор од областа на културата**

Се предвидуваат средства за финансиска поддршка на здруженија на граѓани и фондации кои работат во областа на културата и уметноста, а кои реализираат проекти, манифестации и активности од локален културен интерес. Поддршката ќе се доделува согласно јавен повик и утврдени критериуми.

#### **6.Поддршка на физички лица – самостојни уметници и автори**

Се обезбедуваат средства за поголема и директна поддршка на физички лица – уметници, автори и културни дејци, за реализација на нивните уметнички креации и проекти. Поддршката може да вклучува: кофинансирање на авторски проекти; поддршка за издавачка дејност, изложби, премиери и јавни презентации; поддршка за иновативни и современи уметнички практики.

#### **7.Организација и поддршка на културни манифестации и настани**

Се предвидуваат средства за организација и поддршка на традиционални и нови културни манифестации, фестивали, концерти, изложби, книжевни вечери и други културни настани од значење за локалната заедница.

Во рамки на културните манифестации, Општина Кичево ќе поддржи и организира пригодни културно-уметнички и свечени настани по повод:

- 7-ми март – Денот на наставниците Албанци, со цел афирмација на улогата на наставниците и образованието;
- 22-ри ноември – Денот на албанската азбука, преку културни, едукативни и промотивни активности.

#### **4.Mbështetja dhe stimulimi i talenteve të rinj në fushën e artit**

Sigurohen mjete për mbështetjen e talenteve të rinj në fushën e muzikës, artit figurativ, teatrit, letërsisë, filmit dhe disiplinave të tjera artistike. Mbështetja mund të realizohet përmes: ndihmës financiare për pjesëmarrje në festivale, gara dhe ekspozita; ndarjes së çmimeve dhe mirënjohjeve; furnizimit me materiale dhe pajisje; mbështetjes për programe edukative dhe mentorimi.

#### **5.Mbështetja e sektorit joqeveritar në fushën e kulturës**

Parashikohen mjete për mbështetje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve që veprojnë në fushën e kulturës dhe artit dhe që realizojnë projekte, manifestime dhe aktivitete me interes kulturor lokal. Mbështetja do të ndahet në përputhje me thirrje publike dhe kritere të përcaktuara.

#### **6.Mbështetje për individë – artistë dhe autorë të pavarur**

Sigurohen mjete për mbështetje më të madhe dhe të drejtpërdrejtë për individë – artistë, autorë dhe veprimtarë kulturorë, për realizimin e krijimeve dhe projekteve të tyre artistike. Mbështetja mund të përfshijë: bashkëfinancim të projekteve autoriale; mbështetje për veprimtari botuese, ekspozita, premiera dhe prezantime publike; mbështetje për praktika artistike inovative dhe bashkëkohore.

#### **7. Organizimi dhe mbështetja e manifestimeve dhe ngjarjeve kulturore**

Parashikohen mjete për organizimin dhe mbështetjen e manifestimeve tradicionale dhe të reja kulturore, festivaleve, koncerteve, ekspozitave, mbrëmjeve letrare dhe ngjarjeve të tjera kulturore me rëndësi për komunitetin lokal.

Në kuadër të manifestimeve kulturore, Komuna e Kërçovës do të organizojë dhe mbështesë programe kulturore-artistike dhe aktivitete solemne me rastin e:

- 7 Marsit – Ditës së Mësuesve Shqiptarë, me qëllim afirmimin e rolit të mësuesit dhe arsimit;
- 22 Nëntorit – Ditës së Alfabetit Shqiptar, përmes aktiviteteve kulturore, edukative dhe promovuese.



### 8.Зачувување и промоција на културното наследство

Се предвидуваат средства за активности поврзани со заштита, промоција и презентација на материјалното и нематеријалното културно наследство на Општина Кичево, во соработка со релевантни институции и организации.

### 9.Организација на дочек на Новата 2027 година

Се предвидуваат средства за организација на културно-забавна програма по повод дочекот на Новата 2027 година, со цел збогатување на јавниот културен живот и создавање на заеднички културен настан за граѓаните на Општина Кичево. Средствата ќе се користат за ангажман на изведувачи, техничка поддршка и организациски трошоци.

### 10.Други трошоци поврзани со реализацијата на Програмата

Се предвидуваат средства за други оправдани и неопходни трошоци поврзани со реализацијата на Програмата за култура, кои не можат однапред детално да се предвидат, а се во функција на успешна имплементација на програмските активности.

### III. Табеларен приказ

Бр. / Ставка / Планирани средства

- 1 Благодарници и признанија – 100.000 ден.
- 2 Протоколарни подароци – 300.000 ден.
- 3 Цвеќе и венци – 100.000 ден.
- 4 Поддршка на млади таленти – 700.000 ден.
- 5 Поддршка на невладин сектор – 900.000 ден.
- 6 Поддршка на физички лица – уметници – 700.000 ден.
- 7 Културни манифестации и настани – 600.000 ден.
- 8 Културно наследство – 100.000 ден.
- 9 Дочек на Нова 2027 година – 1.900.000 ден.
- 10 Други трошоци – 600.000 ден.

Завршна напомена

Предлог програмата ќе се реализира согласно можностите на Буџетот на Општина Кичево за 2026 година и во согласност со важечката законска регулатива.

### 8.Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Parashikohen mjete për aktivitete që lidhen me mbrojtjen, promovimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të Komunës së Kërçovës, në bashkëpunim me institucione dhe organizata relevante.

### 9. Organizimi i pritjes së Vitit të Ri 2027

Parashikohen mjete për organizimin e një programi kulturor-argëtues me rastin e pritjes së Vitit të Ri 2027, me qëllim pasurimin e jetës publike kulturore dhe krijimin e një ngjarjeje të përbashkët kulturore për qytetarët e Komunës së Kërçovës. Mjetet do të përdoren për angazhimin e interpretuesve, mbështetje teknike dhe shpenzime organizative.

### 10.Shpenzime të tjera të lidhura me realizimin e Programit

Parashikohen mjete për shpenzime të tjera të arsyeshme dhe të domosdoshme që lidhen me realizimin e Programit për kulturë, të cilat nuk mund të parashikohen në mënyrë të detajuar paraprakisht, por janë në funksion të zbatimit të suksesshëm të aktiviteteve programore.

### III. Paraqitje tabelare

Nr. / Zëri / Mjetet e planifikuara

- 1 Mirënjohje dhe çmime – 100.000 den.
- 2 Dhurata protokollare – 300.000 den.
- 3 Lule dhe kurora – 100.000 den.
- 4 Mbështetje për talente të rinj – 700.000 den.
- 5 Mbështetje për sektorin joqeveritar – 900.000 den.
- 6 Mbështetje për individë – artistë – 700.000 den.
- 7 Manifestime dhe ngjarje kulturore – 600.000 den.
- 8 Trashëgimi kulturore – 100.000 den.
- 9 Pritja e Vitit të Ri 2027 – 1.900.000 den.
- 10 Shpenzime të tjera – 600.000 den.

Shënim përfundimtar

Programi i propozuar do të realizohet në përputhje me mundësitë e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2026 dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.



**ПРОГРАМА ЗА КУЛТУРА на Општина Кичево за 2026 година**

Подготвена од Одделението за култура и спорт при Општина Кичево

За разгледување и усвојување од Советот на Општина Кичево

Подготвувач: Одделение за култура и спорт  
Општина Кичево

Документот е доставен до Советот на Општина Кичево на разгледување и усвојување

**PROGRAM PËR KULTURË  
i Komunës së Kërçovës për vitin 2026**

Përgatitur nga Sektori për Kulturë dhe Sport pranë Komunës së Kërçovës

Për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Komunës së Kërçovës

Përgatitës: Sektori për Kulturë dhe Sport  
Komuna e Kërçovës

Dokumenti i është dorëzuar Këshillit të Komunës së Kërçovës për shqyrtim dhe miratim.